



Datë: 08.04.2025
Numër Protokolli: 2578/2025

A.nr.248/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.248/2025 të datës 31.01.2025 të parashtruar nga ankuesja M.B të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokate Nazmije Ibrahimimi nga Ferizaji, kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.248/2025, e datë 31.01.2025, e parashtruar nga ankuesja M.B.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me shifër: DS-1712/2024 të datës 20.12.2024, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, M.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja) e punësuar në Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 29.01.2025 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar me datë 31.01.2025, me numër protokolli 696/2024 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.248/2025 kundër Vendimit me shifër:DS-1712/2024 të datës 20.12.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 13.03.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, ndërsa për kërkesës për prova shtesë kjo e fundit ka ofruara prova dhe sqarime shtesë me datë 12.03.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 696/2025 të datës 31.01.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 22.11.2024; Vendimi me shifër: DS-1712/2024 të datës 20.12.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.02.2025; Kërkesën e datës 12.03.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 13.02.2025; Kërkesën e ankueses të datës 16.12.2024; Akt Emërimit të ankueses të datës 01.07.2024; Vendimin e datës 07.08.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 31.10.2007 të Qeverisë së Kosovës; Vendimin e datës 18.01.2023 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Listën e pagave të muajit prill 2022; Listën e pagave janar 2023 deri në dhjetor 2024; Vendimin e datës 09.09.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Fletë kthesë e datës 09.01.2025.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji Këshillit ka konstatuar se ankuesja sipas Aktit të Emërimit me shifër: DS-749/2024 të datës 01.07.2024, ka të themeluar marrëdhënien e punës në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGJK), respektivisht në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në pozitën e punës “Arkivist i lartë”-Profesional 1, klasa J15 dhe koeficient të pagës 5.85.

Ankuesja me datë 16.12.2024 i është drejtuar Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me kërkesë për kompensim material, në vlerën e përgjithshme prej 131.20€ ku prej tyre (50€ në emër të shtesës së kufizuar, 31.20€ në emër të shtesës për të punësuarit në administratën shtetërore, si dhe 50€ euro kompensim), për periudhën kohore nga muaji shkurt e deri në muajin dhjetor 2024. Lidhur me kërkesën e ankueses, me datë 20.12.2024 Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së, ka nxjerrë Vendimin me shifër: DS-1710/2024 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 16.12.2024, me arsyetimin se Vendimi i datës 07.08.2018 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes cilit të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor, përveç gjyqtarive e kanë gëzuar shtesën në vlerë prej 150€ në çdo të tretin (3) muaj, sipas pikës 3 të dispozitivit ishte përcaktuar se “Ky vendim do të zbatohet deri në hyrjen në fuqi të ligjit për paga”, dhe si i tillë nuk prodhon efekte pas hyrjes në fuqi të ligjit të pagave, kurse me Vendimin Nr.04/128 të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekuivalentimin e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve, nuk e ka përfshirë Vendimin e datës 07.08.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa lidhur me shtesën në vlerë prej 50€ në emër të shtesës së kufizuar, dhe shtesë në vlerë prej 31.20€ në emër të shtesës për të punësuarit në administratën shtetërore, Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së thekson faktin se shtesat në fjalë tani me ligjin e ri të pagave janë të përfshira në pagën e ankueses.

Në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër Vendimin me shifër: DS-1712/2024 të datës 20.12.2024 të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ankuesja pretendon se organi i punësimit ka nxjerrë aktin duke iu referuar dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ngase me Aktgjykimin për rastin KO79/2023 të datës 24.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës VII, janë shpallur të pavlefshëm, paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (shtesat transitorë) dhe paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa sipas të njëjtit Aktgjykim, pika IX, është përcaktuar se, “TE KONSTATOJE” se deri në plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nga Kuvendi i Republikës

se Kosovës, paragrafi 3 i nenit 2 (Fushëveprimi), paragrafi 2 i nenit 22 (Shtesat), paragrafi 5 i nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 8 i nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafi 7 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafi 4 i nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të zbatohen në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim. Tutje ankuesja në ankesën e saj kërkon që Këshilli të aprovoi si të themeltë ankesën e saj, dhe të ndryshojë vendimin e atakuar me ankesë duke ia njohur të drejtën në kompensim material në vlerën e shumës prej 131.20€ në bazë mujore dhe atë për periudhën kohore për muajt: shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, nëntor dhe dhjetor të vitit 2024.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit pas sqarime dhe provave të kërkuara nga Njësia e Burimeve Njerëzore pranë SKGJK-së, ka pranuar provat e kërkuara dhe sqarimet e dhëna, ashtu që konstatoi se të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor shtesën e kufizuar në vlerë prej 50€, e kishin të fituar nga Vendimi Nr.12/277 i datës 31.10.2007 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, e që qëllimi i saj shtesë sipas pikës 1 të dispozitivit të të njëjtit vendim ishte që të nivelizoheshin pagat e asaj kohe të të punësuarve në Administratën e Juridikaturës me pagat e shërbyesve civil nëpër ministri, kurse shtesën në vlerën prej 150€ në çdo të tretin (3) muaj, apo në ekuivalencë me 50€ na baza mujore e kishin të fituar përmes Vendimi i datës 07.08.2018 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, që është evident fakti se sipas pikës 3 të dispozitivit të të njëjtit vendim ishte përcaktuar se “Ky vendim do të zbatohet deri në hyrjen në fuqi të ligjit për paga”, ndërsa shtesën SHCK në vlerën prej 31.20€ në baza mujore e kishin fituar sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 09.09.2015.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe me rastin e vendimmarrjes mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, në fuqi nga data 05.02.2023, me theks të veçantë: Nenin 1 [Qëllimi] ku përcaktohet se: *1. Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë*, Nenin 2 [Fushëveprimi] paragrafi 1 dhe 3 ku përcaktohet se: *1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë*, Nenin 41, paragrafi 2, 3 dhe 4, përcaktohet: *2. Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100% të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore*, Nenin 45 paragrafi 2, përcakton: *2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.*

Kolegji i Këshillit, thekson faktin e pakontestueshëm se Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, është shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe më datë 23.01.2024, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka publikuar Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, i cili ka hyre

në fuqi më datë 01.02.2024. Përmes këtij aktgjykimi, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka shpallë të pavlefshëm paragrafit 2, 3 dhe 4 të nenit 41 dhe paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa ka detyruar Kuvendin e Republikës së Kosovës që brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi të ndryshojë dhe plotësoj paragrafin 2 të nenit 2 dhe paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje me shqyrtimin e çështjes së ngritur nga pala, konstaton faktin se është fakt i pakontestueshëm që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përmes aktgjykitimit të cekur si më lartë ka shpallur të pavlefshëm paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, mirëpo përmes këtij Aktgjykimi, në **IV. Efektet e Aktgjykitimit** ka sqaruar dhe përcaktuar çështjen e efekteve juridike të këtij aktgjykimi në raport ligjin e kontestuar, ashtu që me pikën 377 të këtij aktgjykimi, specifikon se: *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi), në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 5 i nenit 25 (Shtesa e performancës) dhe paragrafi 4 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën për sa i përket pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese, me theks në institucionet e përcaktuara përmes Kapitullit VII [Sistemi i Drejtësisë], Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura]. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, (i) paragrafi 2 i nenit 2 të Ligjit të kontestuar ua pamundëson institucioneve të pavarura kushtetuese që në përmbushje të pavarësisë së tyre kushtetuese të funksionojnë edhe me ligje të veçanta dhe e kufizon pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore vetëm në nxjerrjen e akteve nënligjore në rrethanat e përcaktuara specifikisht sipas Ligjit të kontestuar; (ii) paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të kontestuar shfuqizon çdo dispozitë të ligjit dhe akt nënligjor që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorive tjera në fushën e pagave, përfshirë të gjitha dispozitat e ligjeve të veçanta që ndërlidhen me institucionet e pavarura kushtetuese dhe aktet e tyre nënligjore; dhe (iii) paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 të Ligjit të kontestuar të lexuar së bashku me paragrafin 2 të nenit 2 të tij, i detyrojnë institucionet e pavarura kushtetuese që t'i nënshtrohen kontrollit të pushtetit ekzekutiv lidhur me përcaktimin e ekuivalencave, përkatësisht krijimin e funksioneve pozitive dhe emërtesave në institucionet e tyre në kundërshtim me garancitë përkatëse kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës”, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, vlerëson se nëse analizohet mirë kjo pikë (377) në kuptim sqarimit të efekteve juridike të aktgjykitimit, përmes të njëjtit sqarim arrihet në përfundimin se me pikën VII të dispozitivit të Aktgjykitimit, Gjykata Kushtetuese paragrafin 2 të nenit 45 të ligjit të cekur si më lartë, e ka shpallur të pavlefshëm vetëm për Institucionet e Pavarura kushtetuese, e në kuadër hynë edhe SKGJK-ja.*

Me vetë faktin që sipas aktgjykitimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është detyruar Kuvendi i Republikës së Kosovës që brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi të ndryshojë dhe plotësoj paragrafin 2 të nenit 2 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, sipas këtij aktgjykimi, është konstatuar fakti se me rastin e plotësim ndryshimit të këtij paragrafi të qartësohet shprehimisht që institucionet e pavarura kushtetuese rregullojnë dhe zbatojnë procedurat përkatëse të Ligjit të kontestuar, jo vetëm përmes akteve nënligjore, por edhe ligjeve të veçanta në përputhje të plotë me pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore të garantuar me Kushtetutë, rrjedhimisht sipas interpretimit apo efekteve të Aktgjykitimit për rastin nr. KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pavlefshmëria e paragrafit 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Pagat në Sektorin Publikë nuk mund të ndërlidhet me institucionet e tjera shtetërore, sepse sipas Kolegjit të Këshillit, nëse i referohemi këtij aktgjykimi i njëjti ka lënë në fuqi të gjitha shtojcat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, të cilët janë të zbatueshme përveç për

institucionet e pavarura kushtetuese ku është garantuar pavarësia kushtetuese e ku këto shtojca aplikohen po në raport me këtë aktgjykim, mirëpo sipas pikës IX të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese është vendosur që, citoj: “IX. **TE KONSTATOJE** se deri në plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, paragrafi 3 i nenit 2 (Fushëveprimi), paragrafi 2 i nenit 22 (Shtesat), paragrafi 5 i nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 8 i nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafi 7 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafi 4 i nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të zbatohen në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim” ashtu, që edhe institucionet e pavarura kushtetuese mund të zbatojnë dhe rregullojnë çështjen e pagave të nëpunësve të tyre mbi bazën e përcaktimeve të ligjit të kontestuar të pagave për atë që vlerësojnë se nuk cenohet pavarësia tyre funksionale deri në plotësim ndryshimin e ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve si në pikën VIII të Aktgjyqimit për rastin nr. KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese.

Po ashtu, Gjykata Kushtetuese përmes sqarimeve të dhëna tek pjesa **IV. Efektet e Aktgjykimit**, ka sqaruar me pikën “376. Konstatimet e Gjykatës sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, ndikojnë në efektet e këtij Ligji në dy mënyra. **E para** ndërlidhet me konstatimet e Gjykatës lidhur me sistemin e pagave dhe shpërblimeve dhe procedurave përkatëse për atë që afektojnë pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese; **ndërsa e dyta** ndërlidhet me konstatimet e Gjykatës lidhur me zbritjen e nivelit të pagës së funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të Shtojcave të Ligjit të kontestuar; sipas sqarimeve në vijim:..”, ashtu që në sqarimet e dhëna përmes pjesës **IV. Efektet e Aktgjykimit**, duke filluar nga pika 373 e deri tek pika 388, Gjykata Kushtetuese sqaron çështjet e vendimmarrjes sipas dispozitivit të të njëjtit aktgjykim, ashtu që përmes të njëjtave pika arrihet në përfundimin se paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, është shpallur i pavlefshëm vetëm ndaj Institucioneve të pavarura kushtetuese dhe Sistemit të drejtësisë, ndërsa paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, shpallen të pavlefshëm për zbatim për të gjitha institucionet shtetërore, e në rrethanat e rastit konkret edhe për Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pasi në këtë kontekst Gjykata Kushtetuese përmes pikës 385 sqaron se: “385. Bazuar në pretendimet dhe argumentet e parashtruara para saj, Gjykata nuk ka trajtuar Shtojcat që janë pjesë përbërëse e nenit 44 të Ligjit të kontestuar. Përkundër faktit që (i) bazuar në vet Ligjin e kontestuar, ulja e pagës mund të bëhet vetëm si rezultat i një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe/ose një fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit 131 të Kushtetutës, përkatësisht shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës; dhe (ii) emëruesit të përbashkët të praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese, GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, që ulja e pagës, në parim, mund të bëhet vetëm në rrethana të krizave ekonomike dhe/ose financiare, Gjykata ka vlerësuar qëllimin e Ligjit të kontestuar për të krijuar “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” si qëllim legjitim. Për pasojë, ajo nuk ka shpallur në kundërshtim me Kushtetutën nenin 44 të Ligjit të kontestuar përkitazi me Shtojcat në lidhje me paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar që përfshinë shfuqizimin e një numri të dispozitave të ligjeve të veçanta dhe të cilat rregullojnë pagën e një numri institucioneve në Republikën e Kosovës. **Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” arrihet përmes paragrafit 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.**

Tutje, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me rastin e trajtimit të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, çështjen e pagës e ka lidhur me të drejtën e pronës e cila nuk mund të

tjetërsohet, dhe mbi këtë konstatim ka folur edhe për çështjen e shtesës tranzitore, e ku Kolegji ju referua pikës 383 të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, ku thuhet: *Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të 110 bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfituar nga shtesa tranzitore prej njëqind për qind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar”, rrjedhimisht sipas këtij përcaktimi, shtesat tranzitore do të jenë aktive derisa paga e re të bëhet e barasvlershme me pagën aktuale, ndërsa shtesa transitore aplikohet apo vjen në shprehje vetëm në situatat kur paga bazë sipas përcaktimeve të këtij ligji është më e vogël sesa paga që një zyrtar ka qenë duke e realizuar para se të hyjë në fuqi ligji i ri i pagave.*

Po ashtu, Kolegji i Këshilli nga analizimi i shkresave të lëndës me qëllim të konstatimit të nivelit të pagës së ankueses para hyrjes në fuqi në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, fillimisht mori përbazë pagën e muajit janar të vitit 2023 dhe konstatoi se sipas listës së pagës ankuesja ka përfituara pagën në vlerë prej **574€** bruto (ku në këtë kalkulim ishte e përfshirë shtesa SHCK 50€ dhe shtesa e kufizuar në vlerë prej 50€, mirëpo në këtë pagë nuk ishte e proceduar shtesa në vlerën prej 150€ sipas Vendimit të datës 07.08.2018 i Qeverisë së Republikës së Kosovës ngase e njëjta shtesë procedohej në çdo të tretin (3) muaj, dhe për rrjedhojë e kishte ekuivalencën e vlerës prej 50€euro për muaj), prandaj sipas këtij sqarimi dhe konstatimi, del që ankuesja para hyrjes në fuqi të ligjit të ri të pagave, ka realizuar pagën në vlerën bruto prej **599€** për muaj.

Mirëpo, pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të pagave, respektivisht Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, sipas listës së pagave ankuesja deri në muajin qershor të vitit 2024 ka realizuar pagë të rregullt bruto, në vlerë mesatare prej **600.00€** në muaj, ndërsa Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 18.01.2023 përmes Vendimit më shifër KGJK.nr.1/2023 kishte bërë klasifikimin e vendeve të punës, ashtu që pozitat e punës të kategorisë Profesional 1, sikurse në pikën 15.23 “Zyrtar Ligjor” pozitë të cilën e mban ankuesja, është përcaktuara në Grupin J, klasa J15, me koeficient të pagës 5.85, ndërsa pas ristrukturimit të institucionit sipas strukturës së re të klasifikimi të vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ankuesja nga muaji korrik i vitit 2024, realizon pagë të rregullt bruto, në vlerë prej **662.081€** në muaj, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesen hyrja në fuqi e ligjit të ri të pagave nuk e ka dëmtuar në aspektin material, për rrjedhojë sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ankueses i është rritur paga, gjegjësisht paga e saj tani është më e lartë sesa paga bazë me të tri shtesat (shtesa e kufizuar, shtesa SHCK dhe shtesa tjetër) e realizuara së bashku, para se ligji i ri i pagave të hynte në fuqi.

Thënë si më lartë, në mbështetje të dispozitave të lartcekura ligjore si dhe në mbështetje të konstatimeve të dhëna si në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se pretendimet ankimor të ankueses lidhur me kompensimin e saj në baza mujore në vlerën prej 130.20€ në muaj nuk është i bazuar, ngase fillimisht është për tu theksuara fakti se me hyrjen në fuqi të ligji të ri të pagave, ankuesja nuk është dëmtuara në pagë, mirëpo tek e njëjta ka pasur rritje të pagës të pasqyruara si më lartë për dy periudha kohore, para klasifikimit dhe pas klasifikimit të vendeve e të punës në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pra mbi këtë

bazë ankueses nuk i është cenuara e drejta në gëzimin e lirë pronës (pagës), sipas frymës së aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Po ashtu lidhur me shtesën e kufizuar në vlerën e 50€ në baza mujore, të fituar në frymën e Vendimit të datës 31.10.2007 të Qeverisë së Kosovës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se sipas pikës 1 të dispozitivit të të njëjtit vendim ishte përcaktuar se, citoj: *“Mbështetet kërkesa e punëtorëve të Administratës së Juridikaturës për nivelimin e pagave të tyre me pagat e shërbyesve civil të ministrive”*, nga rrjedh se vendimi në fjalë në vete nuk ka përcaktuar shtesë specifike apo shuma të përcaktuara, por ua ka njohur të drejtën që të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor të realizojnë pagë të barabartë me të punësuarit apo shërbyesit civil nëpër ministri, prandaj duke marrë parasysh se me Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, jo vetëm kjo e drejtë u është konfirmuar, por del që paga e të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor është më e lart se e të punësuarve në shërbimin civil nëpër ministri, pasi që me shtojcë të veçantë të punësuarit në institucionet e pavarura e në të cilin mes hynë edhe këshilli Gjyqësor i Kosovës, kanë koeficient më të lartë sesa kategoria e njëjtë Profesional 1 nëpër ministri, gjegjësisht sipas Shtojca NR. 2.2. Administrata E Gjyqësorit, në renditjen Nr.4- Kategoria Profesional 1, sikurse është e përcaktuar edhe për ankuesen e kanë koeficientin e pagës 5.85, ndërsa për shembull sipas Shtojca NR. 10.6. - Ministri, Agjenci të Pavarura, Agjenci dhe Rregullatore, Agjenci Ekzekutive dhe të Shërbimit Publik, në renditjen Nr.17-Kategoria Profesional 1 e kanë koeficientin e pagës 5.75, pra kanë koeficient më të vogël, nga rrjedh se për aq kohë se ligji ka trajtuar më mirë apo më në favor të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor sesa që ishte trajtuar rasti përmes Vendimit të datës 31.10.2007 të Qeverisë së Kosovës, është i pa justifikueshëm dhe i pa bazuara fakti që të kërkohet shtesa në emër të ekuivalencës me pagat e të punësuarave në ministri, përderisa sipas ligjit të ri të pagave është e kundërta, pra pagat për kategorinë Profesional 1 të të punësuarve të sistemit gjyqësor sikurse në rrethanat e rastit konkret në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, janë më të larta sesa paga për kategorinë Profesional 1 nëpër Ministri.

Lidhur me shtesën e pretenduar të ankueses në vlerën e shtesës prej 150€ çdo të tretin (3) muaj, apo në ekuivalencën e 50€ për muaj, të fituar sipas Vendimit të datës 07.08.2018 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se sipas pikës 3 të dispozitivit ishte përcaktuar se *“Ky vendim do të zbatohet deri në hyrjen në fuqi të ligjit për paga”*, pra në rrethanat e rastit konkret është imperativ fakti që hyrja në fuqi e ligjit të pagave sipas detyrës zyrtare e ka bërë të pavlefshëm vendimin e lartcekur (*fakt ky i përcaktuar me vetë vendimin në fjalë*), prandaj pretendimi ankimor i ankueses se vendimi në fjalë është shfuqizuar sipas dispozitave të nenit 45 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa paragraf 2 i nenit 45 të të njëjtit ligj ishte shpall i pavlefshëm sipas Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese, që e bënë vendimin valid, është pretendim i pabazuar dhe nuk gjen mbështetje ligjore në aktgjykimin e cekur si më lartë.

Ndërsa sa i përket shtesës SHCK (30) në vlerën prej 31.20€ në baza mujore, Kolegji i Këshillit thekson faktin se kjo shtesë është realizuar mbi bazën e Vendimit Nr.08/48 të datës 09.09.2015, që ka të bëjë me shtesën për shërbimin civil, mirëpo me dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në nenin 22 ka përcaktuar llojet e shtesave: *“Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa*

funkionale.”, mirëpo shtesa e shërbimit civil SHCK, më këtë ligj nuk është paraparë, ndërsa me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23 e datës 23.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është trajtuar kjo çështje dhe sipas dispozitivit si në pikën I është përcaktuar se, citoj: “TE KONSTATOJE se paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi) në ndërlidhje me paragrafin 2 te nenit 24 (Shtesa për kushte te tregut te punës), paragrafin 5 te nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafin 4 te nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafët 2 dhe 3 te nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) te Ligjit nr. 08jL-196 për Pagat ne Sektorin Publik nuk janë ne përputhshmëri me paragrafin 1 te nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 te nenit 7 [Vlerat] te Kushtetutës se Republikës se Kosovës”, nga rrjedh se Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar vetëm për dy (2) lloje të shtesave (Shtesa e performancës dhe Shtesa për vëllimin e punës) që nuk janë ne përputhshmëri me përmbajtjen e caktuar të Kushtetutës se Republikës se Kosovës, nga rrjedh se duke marr për bazë edhe pikë IX të Aktgjykimit në fjalë, citoj: ““IX. TE KONSTATOJE se deri ne plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 te nenit 2 (Fushëveprimi) te Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat ne Sektorin Publik nga Kuvendi i Republikës se Kosovës, paragrafi 3 i nenit 2 (Fushëveprimi), paragrafi 2 i nenit 22 (Shtesat), paragrafi 5 i nenit 24 (Shtesa për kushte te tregut te punës), paragrafi 8 i nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafi 7 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafi 4 i nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) te zbatohen ne përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim”, ashtu që, deri në plotësim ndryshimin e ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve si në pikën IX, çështja e shtesës në fjalë nuk cenon të drejtën nga marrëdhënia e punës së ankueses, pasi që shtesa në fjalë SHCK e njohur me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka qenë e aplikuar për të gjithë të punësuarit në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë nuk ka qenë e përcaktuar vetëm për të punësuarit në Sistemin Gjyqësor të Kosovës, prandaj si i tillë pretendimi në fjalë i ankueses nuk mund të trajtohet ne frymën e rregullimit sipas përcaktimeve të aktgjykimit të cekur si më lartë, e për rrjedhojë pretendim i saj ankimor nuk është i bazuar.

Andaj bazuar në konstatimet si më lartë, Kolegji i Këshillit, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit me shifër: DS-1712/2024 i datës 20.12.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka gjetur se i njëjti akt, është nxjerrë në pajtueshmëri apo zbatim të plotë me dispozitat e aplikueshme nga neni 47 dhe 48 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse ka zbatuar drejtë ligjin material për çështjen e kompensimit të pagave bazë për nëpunësit në sektorin publik, dhe si i tillë akti i goditur me ankesë ka mbetur në fuqi sikurse në dispozitiv e këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankueses është refuzuar pasi që pretendimet e së njëjtës nuk gjejnë mbështetje ligjore në dispozitat a kuadrit ligjor në fuqi të referuar si më lartë.

Andaj, pas konstatimeve të dhëna si më lart dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendim.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.248/2025, datë 13/03/2025.

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, Avokate Nazmije Brahimaj;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë të Burimeve Njerëzore);
- Arkivit të KPMSHCK-së.